



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 64, datë 28.12.2020

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR 2022 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër, me 33 vota Pro,

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Shkodër, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Llesha

KRYETAR


Brisela KADIJA



Lidhja nr.1

KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR 2022

